

KONVENTA MBI SHPËRBLIMIN E BARABARTË, C 100 - 1951

HYRJE

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës,

E mbledhur në Gjenevë nga Organi Drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës dhe duke zhvilluar sesionin e saj të 34 më 6 qershor 1951,

Dhe duke vendosur për adoptimin e disa propozimeve lidhur me parimin e shpërblimit të barabartë, për punë me vlerë të barabartë, për punonjësit burra dhe gra, që është pika e shtatë e rendit të ditës të këtij sesioni, dhe

Duke vendosur që këto propozime të marrin formën e një Konvente ndërkombëtare, miraton në ditën e njëzetënëntë të qershorit të vitit njëmijëenëntëqindpesëdhjetënjë Konventën e mëposhtëme, e cila mund të citohet si Konventa mbi Shpërblimin e Barabartë, 1951:

Neni 1

Për qëllim të kësaj Konvente:

- (a) termi shpërblim përfshin pagën ose rrogën e zakonshme bazë ose minimum dhe çfarëdo lloj pagese që i bëhet punonjësit nga punëdhënësi, drejtëpërsëdrejti apo në mënyrë të tërthortë, me pare në dorë apo në natyrë dhe që është rezultat i punësimit të punonjësit;
- (b) termi shpërblim i barabartë për punonjësit burra dhe gra për punë me vlerë të barabartë i referohet shpërblimit të caktuar pa dallime mbi bazë seksi

Neni 2

1. Secili Anëtar do të zhvillojë, me anën e metodave të përshtatshme që përdoren për caktimin e masës së shpërblimit dhe do të sigurojë, gjithmonë në përputhje me këto metoda, zbatimin për të gjithë punonjësit të parimit të shpërblimit të barabartë për punë me vlerë të barabartë të punonjësve burra dhe gra.
2. Ky parim mund të zbatohet me anën e:
 - (a) ligjeve dhe rregullave kombëtare;
 - (b) mekanizmave të përcaktimit të pagave të krijuara ose të njohura nga ligji
 - (c) marrëveshjeve kolektive midis punëdhënësve dhe punonjësve; ose
 - (d) Kombinimit të këtyre mjeteve të ndryshme

Neni 3

1. Atje ku një veprim i tillë do të ndihmojë në zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente do të merren masa për të bërë vlerësim objektiv të punëve mbi bazën e punës që do të kryhet.

2. Për metodat që do të përdoren në këtë vlerësim mund të vendosim organet përgjegjëse për përcaktimin e masës së shpërblimit ose, atje kur kjo masë vendoset nga marrëveshjet kolektive, palët e interesuara.
3. Përqindje diferencuese midis punonjësve që u korrespondojnë pa dallim seksi, diferencave në punën që kryhet sipas një vlerësimi objektiv nuk do të konsiderohen në kundërshtim me parimin e shpërblimit të barabartë të punonjësve burra dhe gra për punë me vlerë të barabartë.

Neni 4

Secili Anëtar do të bashkëpunojë në mënyrën e duhur me organizatat e interesuara të punëdhënësve dhe punonjësve me qëllim që të zbatohen dispozitat e kësaj Konvente

DISPOZITA PERFUNDIMTARE

Neni 1

Ratifikimi zyrtar i kësaj Konvente i komunikohet Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim.

Neni 2

1. Kjo Konventë është e detyrueshme vetëm mbi ata anëtarë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, ratifikimet e të cilëve janë regjistruar pranë Drejtorit të Përgjithshëm.
2. Konventa hyn në fuqi dymbëdhjetë muaj nga data në të cilën dy anëtarë regjistrohen pranë Drejtorit të Përgjithshëm.
3. Pas kësaj, Konventa hyn në fuqi, për çdo anëtar, dymbëdhjetë muaj nga data e regjistrimit të ratifikimit.

Neni 3

1. Deklaratat që i njoftohen Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës, në përputhje me paragrafin 2 të Nenit 35 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës do të shënojnë:
 - (a) Territoret në të cilat Anëtari përkatës angazhohet që dispozitat e Konventës të zbatohen pa ndryshime;
 - (b) Territoret në të cilat ai angazhohet që dispozitat e Konventës të zbatohen me ndryshime së bashku me hollësitë për këto ndryshime;
 - (c) Territoret në të cilat Konventa nuk mund të zbatohet dhe në këto raste arsyet përse ajo nuk mund të zbatohet;
 - (d) Territoret për të cilat ai mban rezervë për marrjen e vendimit pas shqyrtimit të mëtejshëm të pozitës së vet.
2. Angazhimet për të cilat bëhet fjalë në nënparagrafet (a) dhe (b) të pikës 1 të këtij Neni do të konsiderohen pjesë përbërëse të ratifikimit dhe do të kenë fuqinë e ratifikimit.

3. Secili Anëtar mund të anullojë në çdo kohë, tërësisht ose pjesërisht me anë të një deklarate tjetër, çdo rezervë të bërë në deklaratën fillestare, në funksion të nënparagrafeve (b), (c) ose (d) të pikës 1 të këtij neni.
4. Çdo Anëtar mund t'i komunikojë Drejtorit të Përgjithshëm, në çdo kohë që Konventa është objekt denoncimi në përputhje me dispozitat e nenit 9, një deklaratë që modifikon në çdo drejtim tjetër kushtet e çdo deklarate tjetër të mëparshme dhe që njofton qëndrimin e tanishëm në lidhje me fushat që do të cilësohen prej tij.

Neni 4

1. Deklaratat që i komunikohen Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës në përputhje me paragrafin 4 ose 5 të Nenit 35 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës dotë cilësojnë nëse dispozitat e Konventës do të zbatohen në territorin e caktuar pa ndryshime apo do të ndryshohen; kur në deklaratë cilësohet se dispozitat e Konventës do të zbatohen me ndryshime, do të jepen hollësi për këto ndryshime
2. Anëtari, Anëtarët ose autoriteti përkatës ndërkombëtar me një deklaratë tjetër mund të heqin kohë në çdo kohë tërësisht ose pjesërisht nga e drejta për të patur mundësi për të bërë çdo ndryshim të cilësuar në çdo deklaratë tjetër të mëparshme.
3. Anëtari, Anëtarët ose autoriteti përkatës ndërkombëtar mund t'i komunikojë Drejtorit të Përgjithshëm, në çdo kohë që Konventa është objekt denoncimi në përputhje me dispozitat e nenit 9, një deklaratë që modifikon në çdo drejtim tjetër kushtet e çdo deklarate tjetër të mëparshme dhe që njofton qëndrimin e tanishëm në lidhje me zbatimin e Konventës.

Neni 5

1. Një Anëtar që ka ratifikuar këtë Konventë mund ta denoncojë atë pasi të kenë kaluar 10 vjet nga data e hyrjes së Konventës për herë të parë në fuqi, me anën e një Akti që i njoftohet Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës për regjistrim. Ky denoncim nuk do të jetë i vlefshëm para një viti nga data kur është regjistruar.
2. Secili Anëtar që ka ratifikuar këtë Konventë dhe që brenda një viti pas mbarimit të periudhës prej dhjetë vjetësh të përmendur në paragrafin e mësipërm, nuk e përdor të drejtën e tij për denoncim të parashikuar në këtë nen, do të jetë i angazhuar për një periudhë tjetër prej dhjetë vjetësh dhe, pas kësaj, mund të denoncojë këtë Konventë pas çdo periudhe prej dhjetë vjetësh sipas kushteve të parashikuara në këtë nen.

Neni 6

1. Drejtori i Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës do t'i njoftojë të gjithë Anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për regjistrimin e të gjitha ratifikimeve dhe denoncimeve që i komunikohen atij nga Anëtarët e Organizatës.

2. Kur njofton Anëtarët e Organizatës për regjistrimin e ratifikimit të dytë që i është komunikuar atij, Drejtori i Përgjithshëm do të tërheqë vëmendjen e Anëtarëve të Organizatës për datën kur Konventa do të hyjë në fuqi.

Neni 7

Drejtori i Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës, në përputhje me Nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, dot'i njoftojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara lidhur me regjistrimin hollësitë e plota të të gjitha ratifikimeve dhe akteve të denoncimit të regjistruara prej tij sipas dispozitave të neneve të mësipërme.

Neni 8

Organi drejtues i Zyrës Ndërkombëtare të Punës, do t'i paraqitë Konferencës së Përgjithshme, sa herë që ai ta konsiderojë të nevojshme, një raport mbi funksionimin e kësaj Konvente dhe do të shqyrtojë nëse është e dëshirueshme që të vërë në rendin e ditës së Konferencës çështjen e rishikimit të saj në tërësi ose pjesërisht.

Neni 9

1. Në rast se Konferenca do të adoptojë një Konventë të re që do të ndryshonte këtë Konventë tërësisht ose pjesërisht, dhe në rast se Konventa e re nuk do të parashikonte ndryshe, atëherë:
 - (a) ratifikimi i Konventës së re që ndryshohet nga një Anëtar do të përmbajë ipso jure denoncimin e menjëhershëm të kësaj Konvente pavarësisht nga dispozitat e Nenit të mësipërm, në rast se dhe në momentin që Konventa e re që do të ndryshohet, do të hyjë në fuqi,
 - (b) Që nga momenti që Konventa e re e ndryshuar hyn në fuqi, kjo Konventë nuk do të jetë më e hapur për ratifikim nga Anëtarët.
2. Kjo Konventë do të jetë megjithatë në fuqi, në formën dhe përmajtjen e saj aktuale, për ata Antarë që e kanë ratifikuar atë, por që nuk kanë ratifikuar Konventën e re të ndryshuar.

Neni 10

Versionet në gjuhën angleze dhe frënge të tekstit të kësaj Konvente janë njëllor të barazvlefshme.